

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E TIRANËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Data 10.10.2022

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“MATJET PERJODIKE TË PASAGJERËVE NË SHËRBIMIN E TRANSPORTIT PUBLIK QYTETËS”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV): 48813000-0 48813200-2;  
71700000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: **4,166,667 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

*Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet përkatësisht 1.666,667 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar". Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara....

Si dhe neni 55/4....." Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave."

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.2.2** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, *nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

*Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, kërkohet:

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, si mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, realizimin e censuseve, anketimeve, matje trafiku, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose **833.333 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre)** lekë pa tvsh dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik do të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 dhe neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .....Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të*

fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe i certifikuar me standartin ISO 9001, ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të cilësisë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, e vlefshme. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën/certifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

**Argumentimi:** Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

- a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;
- b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;
- c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

**ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë:** ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar në realizimin e monitorimit dhe matjeve nëpërmjet teknologjisë përkatëse në shërbimin e transportit publik qytetës të Bashkisë së Tiranës, si më poshtë:

**a. 1 (nje) Ekspert kryesor / Menaxher Projekti**

Diplome Universitare në nivel Master në Inxhinieri Ndertimi, minimalisht 5 vite eksperience pune. Të ketë eksperiencë në të paktën një Projekt të ngjashëm. Të ketë njohuri dhe eksperiencë të mëparshme në nivel menaxherial në koordinim dhe implementim projektesh si edhe në administrimin dhe kontrollin e cilësisë.

**b. 2 (dy) Supervizorë/Koordinatorë**

Diplomë Universitare në nivel Master në Inxhinieri Ndertimi ose ekuivalente, minimalisht 3 vite eksperiencë pune. Të ketë eksperiencë në të paktën një Projekt të ngjashëm. Të ketë njohuri dhe eksperiencë të mëparshme në nivel menaxherial në koordinim dhe implementim projektesh si edhe në administrimin dhe kontrollin e cilësisë.

**c. 8 (tetë) Monitorues ne Autobuz**

Diplomë Universitare në nivel Bachelor ose Master në fusha të ngjashme me shërbimet e kërkuara si statistikë, ekonomi apo shkenca sociale ose ekuivalente, minimalisht 2 vite eksperiencë.

**d. 2 (dy) Monitorues ne Stacion**

Diplomë Universitare në nivel Bachelor ose Master në fusha të ngjashme me shërbimet e kërkuara si statistikë, ekonomi apo shkenca sociale ose ekuivalente, minimalisht 2 vite eksperiencë.

**e. 1 (nje) Ekspert IT**

Diplomë Universitare në Informatikë / Informatikë Ekonomike ose ndonjë fushë tjetër ekuivalente. Të ketë eksperiencë profesionale me bazat e të dhënave, komunikimin e sistemeve dhe rrjeteve, transferimin e të dhënave, etj.,

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë në fushat përkatëse të kërkuar,
- Certifikata / kualifikime profesionale (nese ka)
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B;
- Kontrate Pune ose Kontrate Shërbimi për objektin e prokurimit

*Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:*

*Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4 gërma (a) dhe (b):*

*[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës....]*

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 41, pika 4, pika a), b), c):

[4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose....] Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

#### **a. 1 (nje) Ekspert kryesor / Menaxher Projekti**

**Argumentim:** Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të siguronte që çdo pikë e shërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të dokumentave të tenderit.

#### **b. 2 (dy) Supervizorë/Koordinatorë**

**Argumentim:** Ky proces do të monitorohet nga koordinatorët e kompanisë fituese si edhe nga personat përgjegjës të Bashkisë Tiranë. Koordinatorët dhe Supervizorët përgjegjës të Bashkisë së Tiranës do të kontrollojnë çdo ditë oraret e nisjes dhe përfundimit të punës nëpërmjet kontrollit të orarit në aplikacion dhe do të bëjnë raportimet përkatëse. Në rast të mosrespektimit të orarit të punës, sondazhi nuk është i vlefshëm (sipas kërkesave të përcaktuara në termat e referencës bashkëlidhur).

Koordinatorët do të supervizojnë punën e monitoruesve, proceset e punës, përcaktojnë linjat përkatëse sipas planit të punës etj.

### **c. 8 (tetë) Monitorues ne Autobuz**

**Argumentim:** Për të vendosur një sistem i cili konfirmon në mënyrë të pavarur të dhënat e shërbimit të linjave të transportit qytetës, ky proces do të realizohet nëpërmjet monitoruesve me teknologjinë përkatëse që konsiston në matjen e numrit të pasagjerëve që hipin dhe zbresin gjatë stacioneve të secilës linjë të shërbimit të transportit qytetës, si edhe frekuencat e autobusëve, për të gjitha linjat. Të dhënat janë parashikuar që do të merren në çdo periudhë kohore - në mëngjes, në mbrëmje dhe në mesditë, duke përfshirë fundjavat sipas kërkesave të përcaktuara në termat e referencës bashkëlidhur.

Referuar termave të referencës Skuadra 1 përbëhet nga tetë survejues të ndarë në dy turne sipas orarit të mëposhtëm:

Paradite: 06:00-14:00 – 4 monitorues

Pasdite 14:00-22:00 – 4 monitorues

Skuadra 1 “Monitorues ne Autobuz”: do të përdorë një program (softuere) anketimi të bazuar në telefon dhe do të udhëtojë në autobus për të regjistruar numrat e pasagjerëve që hipin dhe zbresin nga autobusi për çdo rrugë. Programi (Softuere) do të jepet nga Bashkia Tiranë.

### **d. 2 (dy) Monitorues ne Stacion**

**Argumentim:** Për të vendosur një sistem i cili konfirmon në mënyrë të pavarur të dhënat e shërbimit të linjave të transportit qytetës, ky proces do të realizohet nëpërmjet monitoruesve me teknologjinë përkatëse që konsiston në matjen e numrit të pasagjerëve që hipin dhe zbresin gjatë stacioneve të secilës linjë të shërbimit të transportit qytetës, si edhe frekuencat e autobusëve, për të gjitha linjat. Të dhënat janë parashikuar që do të merren në çdo periudhë kohore - në mëngjes, në mbrëmje dhe në mesditë, duke përfshirë fundjavat sipas kërkesave të përcaktuara në termat e referencës bashkëlidhur.

Referuar termave të referencës Skuadra 2 përbëhet nga dy survejues të cilët qëndrojnë në stacion dhe shënojnë orarin e mbërritjes së linjës respektive në stacionin përkatës, targën e mjetit, shënim për kapacitetin sipas strukturës së formularit, si dhe emrin e stacionit dhe identifikimin e monitoruesit. Këta survejues do të ndahen në turne sipas këtij orari:

Paradite: 06:00-14:00 – 1 monitorues

Pasdite 14:00-22:00 – 1 monitorues

Skuadra 2 “Monitorues ne Stacion”: do të qëndrojnë në stacionet e përcaktuara nga Bashkia Tiranë dhe do të bëjnë matjet e frekuencave në mënyrë manuale bazuar në një formular. Monitoruesit që do të qëndrojnë në stacione të përcaktuara të linjave sipas planit të punës dhe do të mbajnë shënim në mënyrë manuale orarin e mbërritjes së linjave të caktuara, frekuencën, si dhe ngarkesën e autobusit sipas Formatit ku këto të dhëna do të mbahen shënim.

### **e. 1 (nje) Ekspert IT**

**Argumentim:** Ekspertët e Inovacionit ofrojnë njohuritë e domosdoshme të sektorit në mënyrë që kontrata të orientohet si në produktet e saj dhe si në analizë performace në fushën e inovacionit. Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë që Operatori Ekonomik ofertues është i aftë për administrimin e bazës së të dhënave, komunikimin e sistemeve dhe rrjeteve, transferimin e të dhënave, etj.,

Nisur nga natyra e kontratës objekt prokurimi, kërkesa për këtë ekspert, është e rëndësishme dhe siguron AK se operatori ekonomik ka kapacitetet e duhura për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kontratës.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Duke qenë se projekti në vetëvete është një projekt i cili kërkon një analizë të shërbimit të transportit publik, duke përfshirë të kuptuarit e volumit të përdorimit të tij dhe frekuencave të mjeteve autobusë, nisur nga termat e referencës dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf të diplomuar/ certifikuar në degët/ fushat e sipërpërmendura, për të cilat kërkohet niveli i tyre profesional lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, me qëllim kryerjen e analizave dhe vlerësimeve teknike dhe ekonomike nevojitet përdorimi i përditësuar dhe të dhëna cilësore dhe të besueshme.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë:

- a) 12 (dymbëdhjetë) *smartphone* me sistem operimi Android;
- b) 12 (dymbëdhjetë) karikues dhe bateri ekstra në formë *Power Bank*

\*Plotësimi i kësaj kërkesë do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e Deklaratës Përmbledhëse të Vetdeklarimit, Shtojca 9, në të cilën të përcaktojnë të dhëna të sakta sipas kërkesave të kësaj pike me qëllim që autoriteti të bëjë mundur ballafaqimin e tyre në momentin e dorëzimit të dokumentacionit fizik.

**Argumentimi:** Duke qenë se ky projekt zhvillohet me mbështetjen dhe asistencën e ekspertëve të projektit “Transporti i Qëndrueshëm Urban në Tiranë (SUTi)”, financuar nga Deutsche Gesellschaft für international Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, sipas marrëveshjes nr. prot. 42467, datë 03.12.2020, Programi (Softueri) që do të përdoret, do të jepet nga Bashkia Tiranë. Ky program (softuer) është në format APK, prandaj është e nevojshme që të përdoren vetëm *smartphone* të tipit Android. Kompania e cila projekti [Sustainable Urban Transport in Tirana, i implementuar nga GIZ Shqipëri] ka kontraktuar ofron aplikacionin vetëm në format APK, i cili është format i përdorshëm vetëm prej *smartphone* me sistem operimi Android. Ky lloj formati nuk kërkon pajisje hardware të veçanta dhe specifike, ndryshe nga sistemet e tjera të operimit, sepse ka lehtësi në programim, ofron më shumë alternativa për ndryshime dhe përshtatje të nevojshme. AK ka lidhur një kontratë me këtë kompani që e cila vazhdon deri në Dhjetor 2023 për ofrimin e aplikacionit, trajnimin të survejuesve si dhe përpunimin e të dhënave. Nëpërmjet këtij programi (softueri), secili monitorues do të zhvillojë sondazh hipjeje dhe zbritjeje në autobus.

Pas firmosjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues, Bashkia Tiranë në bashkëpunim me ekspertët e projektit SUTi të GIZ Albania do të organizojë trajnim për survejuesit ku do të:

- Prezantohet aplikacioni me të gjitha funksionalitetet e tij
- Do të instalohet aplikacioni në të gjithë *smartphone* të survejuesve
- Do të bëhet një test survejim për të provuar aplikacionin

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...]

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 41, pika 4.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Neni 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave,



autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 12 (dymbëdhjete) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore (e-Sig02/a) ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, sipas legjislacionit në fuqi. Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4 gërma (a) dhe (b):

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës....]

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 41, pika 4, pika a), b), c):

[4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose....]

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari,

referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):**

Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Si pjesë e procesit të ristrukturimit dhe modernizimit të sistemit të transportit publik në Bashkinë Tiranë, Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor e Bashkisë Tiranë, po zhvillon një sërë aktiviteteve me qëllim përmirësimin e transportit publik. Si pjesë e kësaj nisme, Bashkia Tiranë me mbështetjen dhe asistencën e ekspertëve të projektit “Transporti i Qëndrueshëm Urban në Tiranë (SUTi)”, financuar nga Deutsche Gesellschaft für international Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, sipas marrëveshjes nr. prot. 42467, datë 03.12.2020, po zhvillon një analizë të shërbimit të transportit publik, duke përfshirë të kuptuarit e volumit të përdorimit të tij dhe frekuencave të mjeteve autobusë. Këto të dhëna aktualisht nuk janë plotësisht të disponueshme, ose ka probleme lidhur me vërtetësinë e tyre. Me qëllim kryerjen e analizave dhe vlerësimeve teknike dhe ekonomike nevojitet përdorimi i përditësuar dhe të dhëna cilësore dhe të besueshme. Aktualisht, shkalla e përdorimit nga pasagjerët e mjeteve autobusë të transportit qytetës është i raportuar vetëm në formën e deklarimit nga ana e operatorëve të licensuar që kryejnë shërbimin dhe të dhënat mbi volumet e udhëtimit nuk janë të detajuara. Për më tepër, shkalla e besueshmërisë së këtyre të dhënave duhet të verifikohet. Për të vendosur një sistem i cili konfirmon në mënyrë të pavarur të dhënat e shërbimit të linjave të transportit qytetës, Bashkia e Tiranës ka vendosur që të ndër marrë një proces të realizimit të monitorimit nëpërmjet teknologjisë përkatëse që konsiston në matjen e numrit të pasagjerëve që hipin dhe zbresin gjatë stacioneve të secilës linjë të shërbimit të transportit qytetës, si edhe frekuencat e autobusëve, për të gjitha linjat. Të dhënat janë parashikuar që do të merren në çdo periudhë kohore - në mëngjes, në mbrëmje dhe në mesditë, duke përfshirë fundjavat sipas referencave specifike që do përshkruhen në vijim. Raportet e monitorimit do të mbështesin zhvillimin e ardhshëm të raportimit të volumit/besueshmërisë së përdorimit të transportit publik qytetës në Tiranë, bazuar në sistemin GPS.

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është realizimi i monitorimeve dhe matjeve nëpërmjet teknologjisë përkatëse në shërbimin e transportit publik qytetës të Bashkisë së Tiranës.

Rezultatet e gjeneruara nga ky proces për transportin qytetës do të jenë:

- Profilet e linjave - shtrirja dhe vendëndodhjet e stacioneve
- Shpejtësitë e operimit
- Volumet e hipjes dhe zbritjes në mjetet autobus të secilës linjë qytetës
- Shkalla mesatare e zënies së kapacitetit të mjeteve autobus

- *Frekuencat e shërbimit*
- *Të dhënat GTFS(General Transit Feed Specification: Specifikimet e përgjithshme të furnizimit të transportit, për planifikimin e udhëtimit, analizën e aksesueshmërisë)*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Matjet periodike të pasagjerëve në shërbimin e transportit publik qytetës”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

- *Dokumentat e tenderit*
- *Termtat e referencës/ specifikimet teknike*
- *Relacioni teknik*

**NJËSIA E PROKURIMIT**